

GJYKATA E APELIT
PRISHTINE

Numri i lëndës: PAKR 157/15

Data: 28 maj 2015

Gjykata Themelore: Prishtinë, PKR 282/14

Origjinali: **Anglisht**

Gjykata e Apelit, në trupin gjykues të përbërë prej Gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Radostin Petrov, si kryesues i trupit gjykues dhe gjyqtarit raportues Fillim Skoro si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga Dr. Bernd Dr. Franke, Zyrtar ligjor i EULEX-it, duke vepruar në cilësi të procesmbajtësit,

Në lëndën që ka të bëjë me të pandehurin:

B.D., mashkull, emri i babait S., i lindur më [...] në A., Komuna e D., shqiptar kosovar, me vendbanim në [...];

H.T., mashkull, emri i babait B., i lindur më [...] në B., Komuna e S., shqiptar kosovar, me vendbanim në [...];

Që të dy nga ata të akuzuar sipas aktakuzës së prokurorit publik PPS 45/2012, të datës 19 maj 2014 dhe të parashtruar në Shkrimoren e Gjykatës Themelore në Prishtinë, më 21 maj 2014 për:

Ushtrim të Ndikimit, duke kërkuar, marrjen ose pranimin e ofertës ose duke premtuar të ndonjë avantazhi të pakryer për vetveten apo ndonjë person tjetër lidhur me ushtrimin e ndikimit të papërshtatshëm nga kryerësi mbi marrjen e vendimeve nga personi i autorizuar, nëse është ushtruar ndikimi apo jo apo nëse ndikimi i supozuar shpie tek rezultatet e menduara apo jo, në shkelje të nenit 345, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës së Përkohshme (tash e tutje “KPPK”, në fuqi nga data 6 prill 2004 deri më 31 dhjetor 2012);

E gjykuar në shkallë të parë nga Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykim P. Kr. Nr. 282/14, të datës 4 shkurt 2015, me të cilin të pandehurit **B.D.** dhe **H.T.** janë shpallur fajtor dhe që të dy janë dënuar me një muaj dhe tre muaj burgim. Ata janë urdhëruar gjithashtu të paguajnë së bashku dhe veçmas shumën prej EUR 200 000 si kompensim për konfiskim të shumë

korresponduese të fituar përmes kryerjes së veprës penale. **B.D.** dhe **H.T.** janë urdhëruar të kompensojnë shumën prej EUR 150 secili si pjesë të shpenzimeve të procedurës penale dhe janë liruar për të paguar pjesën shtesë të shpenzimeve;

Mbajtja e ankesave të parashtruara nga avokati mbrojtës M.H. në emër të pandehurit **B.D.** më 10 mars 2015, nga avokati mbrojtës **B.T.** në emër të pandehurit **H.T.** më 9 mars 2015, nga i pandehuri **H.T.** më 10 mars 2015, dhe gjithashtu mbajtja e ankesës së parashtruar nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (tash e tutje PSRK) më 25 shkurt 2015;

Duke marrë parasysh përgjigjen e PSRK-së, të parashtruar më 20 mars 2015;

Duke marrë parasysh kërkesën e prokurorit shtetëror ankues, të parashtruar më 31 mars 2015;

Dhe pas mbajtjes së seancës publike të Gjykatës së Apelit më 25 maj 2015;

Duke këshilluar dhe votuar më 25 maj 2015 dhe më 28 maj 2015;

Duke vepruar sipas neneve 389, 390, 394 dhe 398 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP);

Nxjerr si në vijim:

AKTGJYKIM

Aktgjykimi i nxjerrë i Gjykatës Themelore të Prishtinës më 4 shkurt 2015, PKR. Nr. 282/2014 ndryshohet dhe aktakuza PPS nr.45/2012 e datës 19 maj 2014 dhe parashtrohet më 21 maj 2014 kundër të pandehurve B.D. dhe H.T. refuzohet.

ARSYETIM

I. HISTORIKU PROCEDURAL

Më 1 gusht 2011, Prokurori i PSRK-së Ali Rexha lëshoi një aktvendim mbi inicimin e hetimit kundër pesë (5) të pandehurve, të dyshuar për kryerje të veprave penale të krimit të organizuar, pastrim të parave, dhënie të mitos, dhe pranimi i mitos. Më 31 janar 20-12, gjyqtari i procedurës paraprake vazhdoi hetimin për këto akuza për gjashtë (6) muaj më tej, deri më 1 gusht 2012, sipas numrit të lëndës PPS 48/2011.

Më 21 maj 2012, Prokurori i PSRK-së Ali Rexha lëshoi aktvendim mbi iniciimin e hetimit në lidhje me shtatë të pandehur tjerë, duke përfshirë dy të pandehurit këtu **B.D.**, **H.T.** dhe pesë (5) të tjerë, të dyshuar për kryerje të veprave penale të marrjes së mitos, dhënies së mitos, ushtrimit të ndikimit dhe shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe autorizimit.

Më 23 maj 2012, prokurori i PSRK-së lëshoi urdhër duke bashkuar të dyja lëndët sipas numrit PPS 45/12 dhe më 18 dhjetor 2012, gjyqtari i procedurës paraprake vazhdoi hetimin deri më 21 maj 2013.

Më 4 prill 2013, Prokurori i PSRK-së së EULEX-it Andrew Carney lëshoi një aktvendim mbi zgjerim të akuzave të hetimit kundër të pandehurve, dhe më pas më 20 maj 2013, lëshoi një aktvendim tjetër duke zgjeruar hetimin në lidhje me akuzat e armëve kundër pesë (5) të pandehurve.

Më 16 korrik 2013, Prokurori i PSRK-së së EULEX-it parashtroi kërkesë për vazhdim të hetimit të bashkuar dhe të zgjeruar i cili kishte filluar më 1 gusht 2011.

Më 26 prill 2013 dhe më 11 shkurt 2014, hetimi ishte ndërprerë kundër një numri të pandehurve dhe në aktvendimin e mëvonshëm, kundër të pandehurit **H.T.** në lidhje pretendimet e armëve.

Më 21 maj 2014, prokurori i PSRK-së Andrew Carney parashtroi aktakuzë në lëndën PKr 282/14 kundër të pandehurve këtu të datës 19 maj 2014.

Pas 11 (njëmbëdhjetë) seancave, gjykata e shkallës së parë nxori aktgjykimin kundërshtues më 4 shkurt 2015. Avokati mbrojtës M.H. në emër të pandehurit **B.D.**, avokati mbrojtës B.T. në emër të pandehurit **H.T.** dhe prokurori parashtroi ankesë.

II. PARASHTRESAT E PALEVE

Ankesat

Avokati mbrojtës B.T. më 9 mars 2015 (dërgoi me postë më 6 mars 2015) parashtroi ankesë të datës 6 mars 2015 në Gjykatën Themelore në emër të pandehurit **H.T.** në baza të:

- Shkeljes esenciale të procedurës së përkohshme penale;
- Shkelje të ligjit penal;
- Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- Gabim në vendim të sanksionit penal.

Në lidhje me **shkeljet e dispozitave të procedurës penale**, avokati mbrojtës paraqet që aktgjykimin nuk ishte hartuar në pajtim me nenin 370 të Kodit të Procedurës Penale (tash e tutje

“KPP”) në shkelje të nenit 384 (1.12) 1.12 të KPP. Në veçanti, ai paraqet që Gjykata Themelore në konstatimin që vepra penale ishte kryer ndërmjet prillit dhe qershorit 2009, ka tejkaluar dhe në esencë e ka ndryshuar përmbajtjen e aktakuzës që shprehimisht i referohet datës 16 prill 2009. Ai paraqet që Gjykata Themelore ka dështuar të përshkruaj veprimet individuale të secilit të pandehur dhe lidhjen kauzale me qëllim të dënimit të atyre për veprën penale. Avokati mbrojtës më tej pohon që aktgjykimi nuk mund të bazohet në dëshmitarëve S.Z., A.J., I.M. dhe Z.B. të cilët janë marrë në pyetje në cilësi të pandehurve në këtë do të përbënte në shkelje të nenit 262 (2) të KPP. Ai gjithashtu pretendon që Gjykata Themelore e bazoi aktgjykimin e saj mbi provat që ishin ofruar në mënyrë të paligjshme.

Sipas avokatit mbrojtës, aktgjykimi është kontradiktor ndërmjet dispozitivit të tij dhe arsytimit të tij në deklarin e të cilit nuk mund të dëshkohet se çfarë lloj ndikimi ishte bërë përpjekje nga të pandehurit përderisa kjo përbën një element të veprës penale. Sipas mendimit të tij, aktgjykimi është më tej kontradiktor në lidhje me sasinë e të hollave të pranuar nga të pandehurit. Ai gjithashtu paraqet që Gjykata Themelore ka gabuar në mbështetjen në SMS pasi që ato nuk mund të përbëjnë prova për të vërtetuar fajësinë e të pandehurve pasi që ata nuk kanë pasur komunikim me shkëmbyesit e këtyre SMS-ve.

Në lidhje me **shkeljet e ligjit penal**, avokati mbrojtës pohon që në bazë të provave të administruara, nuk ka konfirmim të mjaftueshëm për të vërtetuar veprën penale përtej pragut të arsyeshëm të dyshimit të bazuar. Sipas atij, Gjykata Themelore dështoi të adresoj kërkesën e mbrojtës të paraqitur në seancë në shkelje të vjetërsimit relativ për veprën. Ai gjithashtu paraqet që Gjykata Themelore ka gabuar në shpalljen e dy të pandehurve fajtor si bashkë kryerës sipas nenit 23 të KPPK pasi që asnjë prej kritereve nuk janë plotësuar për bashkë kryerje, do të thotë që veprimet e çdo kryerësi duhet të jenë të ndara, duhet të përbëjnë elemente të veprës penale, dhe duhet të jetë specifike në marrëveshje në të cilën bashkë kryerësi është dashur të pajtohet.

Në lidhje me **vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike**, avokati mbrojtës pohon që asnjë nga dëshmitarët nuk ka treguar që të pandehurit kanë ndonjë ndikim në lidhje me fitimin e tenderit. Veç kësaj, ai paraqet që asnjë nga dëshmitarët, përveç S.Z., e ka njohur dhe identifikuar ata në gjykatë. Sipas atij, parimi i “*in dubio pro reo*” duhet të aplikohet dhe duhet të shkoj në favor të akuzuarve.

Në fund, sa i përket **vendimit mbi sanksionet penale**, avokati mbrojtës tregon që Gjykata Themelore ka bërë gabim në urdhërimin e konfiskimit si kompensim pasi që nuk ka palë të dëmtuar në këtë rast.

I pandehuri H.T. më 10 Mars 2015 (e dërguar me poste me 6 Mars 2015) ka ushtruar ankesën me datën 4 Mars 2015 në gjykatën themelore mbi bazat si me poshtë:

- Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale
- Shkelje të Kodit Penal;
- Vërtetimi i gabuar dhe jo i plote i gjendjes faktike;
- Gabime në vendimi mbi sanksione penale

Lidhur me **shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale H.T.** tregon se aktgjykimi nuk është hartuar në pajtim me kriteret e nenit 370 (7) të KPP-se, pasi që gjykata themelore nuk ka deklaruar qarte dhe në mënyrë të hollësishme se cilat faktet janë marre parasysh si të dëshmuara apo jo, dhe baza për këtë, mirëpo ka dështuar që të beje vlerësimin e provave kontradiktore. Në veçanti ai pretendon se me qellim të krijimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të pandehurve në pajtim me nenin 345 (1) të KPPK-se, duhej të vërtetohej që të pandehurit kane përfituar dobi të kundërligjshme me qellim të zgjerimit të ndikimit në marrjen e vendimeve të zyrtarit publik, mirëpo gjykata themelore ka dështuar që të beje një gjë të tillë dhe me se shumti është mbështetur mbi supozime se sa në faktet e krijuara.

H.T. po ashtu pretendon se incizimi me video i siguruar nga dëshmitari A.J. përmban provat të papranueshme dhe se A.J. ka kryer veprën penale të “përgjimit të paautorizuar” në pajtim me nenin 204 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin vijues KPRK-se). Me saktësisht ai pohon se në pajtim me nenin 256 të KPPK-se fotografimi i fshehte apo vëzhgimi me video mund të kryhen vetëm përmes “ zyrtarit të autorizuar policor’ dhe se në pajtim me nenin 258 dhe 259 të KPPK-se vetëm prokurori special i shtetit dhe gjyqtari i procedurës paraprake mund të lëshojnë një urdhër për kësi lloj të vëzhgimit.

Ai argumenton se gjykata themelore ka gabuar në deklarinë se të drejtat të parapara në nenin 123 të KPP-se për marrjen në pyetje të tërthorët po ashtu janë të aplikueshme gjatë marrjes së drejtpërdrejt në pyetje duke ditur se nenin 335 i KPP-se nuk parasheh të drejtën që të behet marrja në pyetje të tërthorët e dëshmitarit gjatë rimarrjes së drejtpërdrejtë në pyetje. Se fundi **H.T.** shpreh se aktgjykimi është në kundërshtim pasi që gjykata themelore në një anë deklaron se ekziston mungesa e njohurisë konkrete të rrethanave të ushtrimit të ndikimit dhe se ky element është i parëndësishëm dhe në anën tjetër deklaron që është miratuar përtej dyshimit të arsyeshëm se një lloj ndikimi është ushtruar¹.

Lidhur me shkeljen e Kodit Penal, H.T. se pari pretendon se gjykata themelore ka gabuar në bërjen e interpretimit të gabuar të veprës penale dhe në aplikim të gabueshme të së drejtës materiale. Më konkretisht ai pohon se elementet e veprës penale nuk janë plotësuar dhe se gjykata themelore nuk ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshme kundër kujt është ushtruar ndikimi ose është premtuar që është ushtruar duke ditur faktin se ka dështuar që të përcaktoj nëse dobia ishte e kundërligjshme dhe identiteti i zyrtarëve të AKP është i përfshirë. Ai po ashtu debaton se gjykata themelore nuk ka analizuar natyrën e këtij ndikimi si element fundamental në konstatimin e përgjegjësisë penale të të pandehurve. Lidhur me këtë ai paraqet se ushtrimi i ndikimit mund të ekzistojë vetëm nëse i akuzuari përmes pozitës së tij mundet në mënyrë objektive dhe formale të ushtrij ndikim, e që nuk është rasti i të pandehurit në instancën aktuale.

¹ Ankesa T., paragrafët 16, 17, duke u referuar gjykatës themelore, aktgjykimi, paragrafët 76.77

Më tej, **H.T.** debaton se parashkrimi relativ dhe absolut tani me kane skaduar. Lidhur me parashkrimin relativ dhe duke ditur se vepra penale është kryer në mes të datës 14 Prill dhe 20 Maj 2009, ai pretendon se ka skaduar duke ditur se Prokurori e ka lëshuar aktvendimin e tij mbi iniciimin e procedurës me 21 Maj 2012, prandaj pas afatit të përcaktuar të përshkruar nenin 90 (1.6) të KPPK-se. Lidhur me parashkrimin absolut ai pohon se gjykata themelore ka gabuar në aktvendimin e saj të datës 10 shtator 2014 duke vendosur të favorizoj versionin e Anglishtes ndaj versionit të gjuhës shqipe të KPPK-se. Sipas tij versioni i gjuhës shqipe duhet të mbizotëroj në rast të ndonjë paqartësie, gjykata themelore kishte obligimi që të interpretoj dispozitivin në favor të të pandehurit në pajtim me nenin 1 (3) të KPPK-se dhe mbi bazën se versioni anglisht nuk është nder gjuhët zyrtare në Republikë në pajtim me kushtetutën. Prandaj, ai pohon se parashkrimi absolut në pajtim me nenin 91 (6) të KPPK-se është i periudhës prej dy vjetëve, dy here, dhe ka skaduar.

H.T. me tej paraqet se gjykata themelore **gabimisht dhe në mënyrë jo të plote e ka vërtetuar gjendjen faktike** të rastit në kundërshtim me nenin 3 dhe 7 të KPP-se. Në veçanti, ai pohon se, për shkak se këto elemente nuk mbështeten me prova, gjykata themelore ka gabuar në gjetjen se: (i) grupi nuk ka mundur në mënyrë ligjore të fitoj tenderin; (ii) partneriteti i të pandehurve në projektet si aksionare duke mos pasur nevojë që në mënyrë financiare të kontribuojnë ishte kompensim për ushtrim të me hershem të ndikimit gjersa në të njëjtën kohë duke gjetur se ky lloji i ushtrimit et ndikimit nga të pandehurit nuk mund të vërtetohet; (iii) e pandehurit kishin kontakte zyrtare me AKP-në. Përveç kësaj **H.T.** paraqet se as provat të administruara nga gjykata e as deklarata e dëshmitareve nuk mund të vërtetonin gjendjen faktike përtej ndonjë dyshimi të bazuar dhe të konfirmojnë elementet të veprës penale të ushtrimit të ndikimit.

Lidhur me **vendimin mbi sanksionet penale**, **H.T.** paraqet se gjykata themelore ka dështuar që të konsideroj nëse vepra penale nenin 345 (1) e KPPK-se është kryer me qëllim të arritjes së një rezultati ilegal dhe ka dështuar të merr në konsideratë rregullat lidhur me zbutjen e ndëshkimit.

Përveç kësaj ai pretendon se gjykata themelore nuk ka mundur të vërtetoj se përfitimi material është fituar përmes veprës penale të ushtrimit të ndikimit dhe se ka pasur lidhje direkte në mes të veprës penale dhe fitimit me qëllim të miratimit të konfiskimit. **H.T.** pohon se barra e të provuarit lidhur me këtë i mbetet Prokurorisë në pajtim me nenin 275 të KPPK-se. Në çdo rast ai argument se gjykata themelore nuk ka mundur të konstatoj mbi paligjshmërinë e këtij përfitimi.

Avokati mbrojtës M. H. më 10 Mars 2015 (e dërguar me poste me 6 Mars 2015) ka ushtruar ankesën me datën 5 Mars 2015 në gjykatën themelore në emër të të pandehurit **B.D.** mbi bazat vijuese:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- Shkeljes së ligjit penal;
- Vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike;
- Gabimit në vendimin lidhur me sanksionet penale.

Në lidhje me **shkeljet esenciale të procedurës penale**, avokati mbrojtësi parashtrohet se dispozitivi i aktgjykimit, në shkelje të neneve 384 (1,12), 370 (4) dhe 365 (1.1) të KPP-së, nuk është i qartë në lidhje me aktet konkrete të të pandehurit, identifikimin e zyrtarit(ëve) të përfshirë në procedurë dhe ndikimin konkret të ushtruar, duke pasur parasysh se të gjitha këto elemente janë të nevojshme në mënyrë që të vërtetohet vepra penale. Ai më tej pretendon se Gjykata Themelore ka shkelur të drejtat e mbrojtjes në bazë të nenit 384 (2.1) dhe (2.2) të KPP-së dhe më veçanërisht parimin e barazisë mes palëve për shkak se ai shpërfill kundërshtimet e mbrojtjes në lidhje me mënyrën se si prokurori special ka marrë në pyetje dëshmitarët e tij, në kundërshtim me nenet 333 deri 335 të KPP-së dhe për shkak se mbrojtja ishte privuar nga mundësia për të kryer në mënyrë efektive marrjen në pyetje në mënyrë të tërthortë.

Sa i përket **vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike**, avokati mbrojtës pohon se i pandehuri ishte “viktimizuar duke u përdorur si pretekst për të mbuluar biznesin e pandershëm në mes të grupit”. Në veçanti, ai tregon për S.Z., i cili u përpoq të pohonte se të dy të pandehurit kanë kërcënuar grupin, në mënyrë që të zhvatnin 200,000 euro, ndërsa ky pretendim u hodh poshtë nga Prokuroria. Ai pretendon se Gjykata Themelore ka gabuar duke mos e mbështetur aktgjykimin e saj në provat e administruara gjatë gjykimit dhe në duke u mbështetur në deklaratat e dëshmitarëve të dhëna gjatë procedurës paraprake, në shkelje të nenit 123 (2) dhe nenin 361 (1) të KPP-së. Avokati mbrojtës pretendon se dëshmia e S.Z. nuk duhet të konsiderohet si e besueshme, duke pasur parasysh dëshmitë kontradiktore dhënë veçanërisht nga dëshmitarët Z.B., I.M., A.J., dhe H.K. Prandaj, ai argumenton se provat e paraqitura gjatë gjykimit nuk vërtetojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri ishte i implikuar në kryerjen e veprës penale me të cilën ai është ngarkuar.

Lidhur me **shkeljet e ligjit penal**, sipas avokatit mbrojtës, duke pasur parasysh se vepra penale e ushtrimit të ndikimit është listuar nën kapitullit e veprave penale kundër detyrës zyrtare, është dashur të jetë vërtetuar se i akuzuari kishte status zyrtar dhe se e ka përdorur detyrën e tij ose të saj në mënyrë që të ushtrojë ndikim. Megjithatë, ai pretendon se **B.D.** nuk mban asnjë pozitë zyrtare dhe për këtë arsye nuk ka mundur të ketë ushtruar ndikim të ushtruar mbi zyrtarët e AKP-së. Ai gjithashtu argumenton se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri ka pranuar ndonjë sasi në emër të përfitimit të pretenduar, pasi që shumica e dëshmitarëve përveç për S.Z. e kanë përjashtuar këtë mundësi.

Përfundimisht, sa i përket **vendimit lidhur me sanksionet penale**, avokati mbrojtës argumenton se fakti që **B.D.** nuk ka qenë i dënuar më parë, se ai është sjellë në mënyrë korrekte gjatë

procedurës, se ai ka një familje me fëmijë dhe se ai ka një gjendje të varfër ekonomike, përbën arsye të mjaftueshme për dënim më të butë. Ai më tej pohon se vendimi për të kompensuar sasinë prej 100.000 euro është ligjërisht i pabazuar pasi përfitimi asnjëherë nuk është realizuar dhe pasi që një kompensim të tillë mund ta kërkojë vetëm pala e dëmtuar, e cila supozohet të ketë dhënë këtë shumë.

Prokurori special Andrew CARNEY më datën 25 shkurt 2015 parashtroi një ankesë të datës 25 shkurt 2015, në Gjykatën Themelore për shkak të:

- Gabimit në vendimin lidhur me sanksionet penale dhe vendimet tjera

Më konkretisht, prokurori special argumenton se shqiptimi i dënimit me burgim prej një viti e tre muajsh, ishte caktuar gabimisht në pajtim me nenin 83 (1), nenin 383 (1.4) dhe nenin 387 (1) të KPP-së dhe se të pandehurit duhej të ishin dënuar për afërsisht me dënimin maksimal të paraparë për këtë veprë penale, në mënyrë që të arrihej serioziteti i tij. Ai pretendon se Gjykata Themelore duhet të ketë marrë parasysh se sipas kodit të ri penal dënimi për veprën penale të ushtrimit të ndikimit është ngritur në mënyrë të konsiderueshme në maksimum prej tetë vjetësh burgim, duke vërtetuar se lartësia fillestare për këtë veprë penale është konsideruar të jetë shumë e ulët.

Prokurori special më tej vë në dukje se ishin të pranishëm një numër faktorësh rëndues, domethënë, shkelja ishte me vlerë të lartë monetare, është kryer për një periudhë kohore, ka kërkuar paramendim dhe ka përfshirë palë të shumta. Përveç kësaj, asnjë nga të pandehurit nuk ka pranuar fajësinë, nuk ka shprehur keqardhje apo të ketë ndihmuar Prokurorinë. Sipas prokurorisë speciale, përveç mungesës së mëparshme, nuk ka faktorë tjerë lehtësues.

Përveç kësaj, prokurori special pretendon se në pajtim me nenin 54 të KPPK-së, Gjykata e Apelit duhet të urdhërojë një dënim plotësues me anë të një gjobe të rëndësishme për të dy të pandehurit, në mënyrë që të reflektohet pesha e veprës së kryer penale.

Prandaj, prokurori special i propozon Gjykatës së Apelit që të ndryshojë aktgjykimin pjesërisht, në mënyrë që të shqiptojë një dënim afër maksimumit dhe një dënim plotësues. Prokurori special nuk paraqet ankesë ndaj gjetjeve faktike të bëra nga ana e Gjykatës Themelore por vetëm për shkallën e dënimeve të shqiptuara.

Përgjigje ndaj ankesave

Prokurori special Andrew Carney, më datën 20 mars 2015, paraqiti një përgjigje të datës 19 mars 2015 në të cilën ai i kërkon Gjykatës së Apelit që të refuzojë në tërësi ankesat e të pandehurve si të pabaza. Në kundërshtim me pohimin e mbrojtjes se dëshmitë janë dëgjuar në kundërshtim me KPP-në, prokurori special parashtroi se nuk ka pasur kurrfarë shkelje të rregullave procedurale që do të rrezikonin dënimet.

Prokurori special kundërshton gjithashtu argumentet e mbrojtjes në lidhje me periudhën e parashkrimit dhe miraton arsyetimin që gjendej brenda aktvendimit të lëshuar nga kryetari i trupit gjykues më datën 10 shtator 2014. Prokurori special më tej pretendon se Gjykata Themelore me të drejtë ka konstatuar se vepra penale për të cilën janë dënuar të dy të pandehurit ka ndodhur në mes të prillit dhe qershorit të vitit 2009, pra pas datës së ofertës për tender, më 20 maj 2009.

Avokati mbrojtës M.H. për B.D. është përgjegjës ndaj ankesës së prokurorit special me anë të ankesës së tij të paraqitur më 10 mars 2015. Ai parashtron se ankesa e prokurorit special duhet të refuzohet si e pabazë duke pasur parasysh se prokurori special i referohet dënimit të veprës penale nën kodin e ri penal, i cili nuk zbatohet, dhe duke pasur parasysh se prokurori nuk mund të konsiderojë si rrethana rënduese faktorët që tanimë janë pjesë e elementeve përbërës të veprës penale.

Propozimi i prokurorit të apelit

Prokurori i apelit Claudio Pala në propozimin e tij të datës 30 mars 2015, të paraqitur më datën 31 maj 2015, parashtron se Gjykata Themelore në mënyrë të plotë dhe me saktësi ka vlerësuar provat, ka dhënë arsye se pse nuk ka përfshirë dëshmitë e dëshmitarëve dhe në mënyrë korrekte e ka konsideruar si të pranueshëm video incizimin. Ai thekson se dispozitivi i aktgjykimit duhet vetëm të shpreh akuzat dhe vendimin në mënyrë sintetike, sepse faktet janë deklaruar në mënyrë të qartë dhe me hollësi në pjesën e arsyetimit të vendimit. Prokurori i apelit, duke iu referuar nenit 12 të Konventës për Ligjin Penal mbi Korrupsionin të Këshillit të Evropës, plotësisht miraton arsyetimin e Gjykatës Themelore, se është e parëndësishme për ekzistimin e veprës penale të ushtrimit të ndikimit, sipas nenit 345 (1) të KPPK-së, nëse ndikimi është ushtruar apo jo.

Sa i përket parashkrimit, ai vëren se dispozita përkatëse që do të aplikohet është neni 90 (1.5) i KPPK-së, dhe jo neni 90 (1.6), siç është pohuar nga mbrojtja. Ndërsa prokurori i apelit pranon se që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës, gjuha shqipe dhe gjuha serbe janë gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës, ai vëren se versioni në gjuhën shqipe i kodit përmban një gabim të dukshëm dhe se versioni autentik në gjuhën serbe përputhet me versionin në gjuhën angleze.

Prokurori i apelit parashtron se periudha e parashkrimit është ndërprerë sipas nenit 91 të KPPK-së më datën 20 prill 2012, kur departamenti special kundër korrupsionit i Policisë së Kosovës i dorëzoi prokurorit special dosjen kundër të pandehurve.

Bazuar në atë që u tha më lart, prokurori i apelit i propozon Gjykatës së Apelit që të refuzojë arsyet e ankesës të paraqitura nga dy të pandehurit dhe të pranojë ankesën e prokurorit speciale kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

III. Gjetjet

Kompetenca e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit është gjykata kompetente për të vendosur lidhur me Ankesën në pajtim me nenin 17 dhe nenin 18 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr. 03 / L-199).

Trupi Gjykues i Gjykatës së Apelit është i përbërë në pajtim me nenin 19 paragrafin (1) të Ligjit për Gjykatat dhe nenit 3 të Ligjit Nr 03 / L-053 mbi Juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

Pranueshmëria e Ankesave

(1) Ankesat kundër Aktgjykimit

Ankesat janë të pranueshme. Aktgjykimi i kontestuar u shpall më 4 shkurt 2015. Aktgjykimi në formë të shkruar iu dorëzua të pandehurve më 20 shkurt 2015. Aktgjykimi iu dorëzua avokatit mbrojtës M.H. më 27 shkurt 2015 dhe avokatit mbrojtës B.T. më 20 shkurt 2015. Aktgjykimi iu dorëzua Prokurorit më 18 shkurt 2015. Ankesat u paraqitën brenda afatit 15-ditor në përputhje me nenin 380 (1) të KPP-së dhe nga ana e personit të autorizuar.

Skadimi i parashkrimit

Parashkrimi ka skaduar.

Për shkak të kohës së kryerjes së veprës penale duhet të përdoret kodi i vjetër penal. Parashkrimi për këtë çështje penale gjendet në nenin 90 (1.6) KPPK, ku thuhet se ndjekja penale nuk mund të fillohet pas dy (2) vitesh nga kryerja e veprës penale që është e dënueshme me burgim prej më shumë se një (1) viti ose me gjobë. Ky argument mund të jetë i vlefshëm në versionin shqip të KPPK-së.

Në versionin anglisht / serbisht, Neni 90 (1.6) të KPPK-së, thotë se parashkrimi llogaritet deri në dy (2) vite nga kryerja e veprës penale që është e dënueshme me burgim deri në një (1) vit apo dënimi me gjobë, ndërsa neni 90 (1.5) i KPPK-së thotë se kjo është tri (3) vjet pas kryerjes së një vepre penale e dënueshme me burgim prej më shumë se një (1) vit.

Sipas versionit shqip, pengesa absolute ka skaduar pasi që janë plotësuar katër (4) vite - dy herë ka kaluar periudha prej dy (2) vitesh (neni 91, paragrafi 6 i KPPK). Gjykata Themelore i ka gjetur dy të pandehurit fajtorë se në periudhën kohore në mes të prillit 2009 dhe qershorit 2009 e kanë kërkuar dhe e kanë marrë shumën prej 200.000 euro nga një grup prej pesë individëve. Prokurori Special nuk paraqet ankesë në lidhje me gjetjet faktike të bëra nga ana e Gjykatës Themelore, por vetëm lidhur me shkallën e dënimit të shqiptuar. Prandaj Gjykata e Apelit nuk mund të shkojë përtej qershorit 2009 dhe nëse Trupi gjykues e konsideron versionin shqip të aplikueshëm, atëherë parashkrimi ka skaduar më së largu më 30 qershor të vitit 2013.

Sipas versionit anglisht/ serbisht, pengesa absolute nuk ka skaduar ende, pasi që është e vlefshme dy herë periudha prej tri (3) vjetësh.

Sipas nenit 356 të KPPK-së, versionet në anglisht, në shqip dhe në serbisht të kodit janë njëlloj autentike. Në rast të konfliktit, do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze. Kjo do të thotë se për shkak të mospërputhjeve të gjuhës ne duhet të përdorim versionin në gjuhën angleze/ serbe. Ky argument është i vlefshëm deri më 14 qershor 2008.

Megjithatë, Gjykata e Apelit e merr në konsideratë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila ka qenë në fuqi që nga 15 qershori 2008. Sipas nenit 5 të Kushtetutës gjuhë zyrtare në Kosovë janë gjuha shqipe dhe serbe. Anglishtja nuk është ndër gjuhët zyrtare në Kosovë më. Në bazë të nenit 3 të Ligjit Nr. 03 / L-053 mbi Juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, gjuha zyrtare në procedurat, në të cilat janë të përfshirë gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it, është edhe anglishtja. Pas 15 qershorit 2008 gjuhë zyrtare për legjislacion janë gjuha shqipe dhe serbe dhe asnjëra prej tyre nuk mbizotëron. Gjykata e Apelit konstaton se versionet e gjuhës në Nenin 90 (1.6) të KPPK-së janë thelbësisht të ndryshme.

Përgjigje për pyetjen, se cili version i ligjit duhet të zbatohet në këtë rast të mospërputhjeve të gjuhës është dhënë në Nenin 3 (2) të KPP-së². Sipas këtij neni, dyshimeve në lidhje me zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal do të interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij ose të saj në bazë të Kodit të Procedurës dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prandaj, Gjykata e Apelit konstaton se versioni në gjuhën shqipe është më i favorshëm për të pandehurin dhe duhet të zbatohet. Prandaj, parashkrimi në pajtim me nenin 91 (1.6) të KPPK-së është i një periudhe prej dy (2) vitesh. Kështu, ekziston skadimi i parashkrimit absolut më së largu në qershor të vitit 2013.

Në bazë të këtyre që u thanë më sipër, Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë dhe e hedh poshtë akuzën e prokurorisë.

Nga ajo që u përmend më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimit.

Aktgjykimi i arsyetuar me shkrim u përfundua me 11 qershor 2015.

Kryetari i trupit gjykues

Radostin Petrov

² Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, PN1 2486/ 14, date 19 dhjetor 2014

Gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i trupit gjykues

Roman Raab

Gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i trupit gjykues

Fillim Skoro

Gjyqtar i Kosovës

Procesmbajtës

Dr. Bernd Franke

Zyrtar Ligjor i EULEX-it

Gjykata e Apelit

Prishtinë

PAKR 157/15

28 Maj 2015